  - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
  - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
  - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.

4. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të pikes 3, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

---

## SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Kërkesës për pjesëmarrje

Shtojca 2. Ftesa për Ofertë për kandidatët e përzgjedhur faza II

Shtojca 3. Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 4 Lista e Çmimeve të Shërbimeve

Shtojca 5. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 6. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 7. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 8. Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 9. Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 10. Formulari i Kriterëve Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 11. Formulari i Përmbledhës i Vetdeklarimit

Shtojca 12. Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 13. Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

Shtojca 14. Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca 15. Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraparak)

Shtojca 16. Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit)

**Shtojca 1**

*(Shtojca për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik)*

**FORMULARI I KËRKESËS PËR PJESËMARRJE**

Emri i **Operatorit Ekonomik** \_\_\_\_\_

Drejtuar: *[Emri dhe adresa e autoritetit /entit kontraktor]*

\* \* \*

Procedura e prokurimit: *[lloji i procedurës]*

Numri i procedurës / referenca e Lotit

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Botimi (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data]

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, në, të nënshkruarit paraqesim shprehjen tonë të interesit për të marrë pjesë në këtë procedurë.

**Emri i Përfaqësuesit të Ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

**Shtojca 2**

*(Shtojcë për tu plotësuar nga autoriteti /enti kontraktor vetëm për operatorët ekonomikë të kualifikuar/  
përzgjedhur bazuar në kërkesen per pjesemarrje)*

**FORMULAR I FTESËS PËR OFERTË**

[Datë]

Drejtuar: *[Emri dhe adresa e operatorit ekonomik të kualifikuar /përzgjedhur]*

Procedura e prokurimit \_\_\_\_\_/

Numri i procedurës / referenca e Lotit \_\_\_\_\_

Në referencë të procedurës së lartpërmendur ju bëjmë me dije se [emri dhe adresa e kandidatit të përzgjedhur], pas vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur në fazën e parë Ju jeni kualifikuar për fazën ofertuese të kësaj procedure prokurimi.

Për këtë arsye, ju kërkojmë të paraqisni pranë [këtij autoriteti/enti kontraktor]

Emri \_\_\_\_\_

Adresa \_\_\_\_\_

Ofertën tuaj, duke marrë në konsideratë si më poshtë:

**Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertës është:**

Data (d/m/v)

Ora: \_\_\_\_\_

Adresa \_\_\_\_\_

Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin ofertën në formë elektronike në ueb-faqen zyrtare të APP, [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al).

**Informacioni mbi ofertat e paraqitura me mjete elektronike i transmetohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë dorëzuar oferta, në bazë të kërkesës së tyre.**

**Gjuha (ët) e hartimit të ofertës është:**



Shqip                       Anglisht

Tjetër \_\_\_\_\_

### **Kriteret e përzgjedhjes së fituesit**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit janë si më poshtë:

#### **A) oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto**

Sipas rëndësisë:

Çmimi       pikët

\_\_\_\_\_  pikët

\_\_\_\_\_  pikët

\_\_\_\_\_  pikët

Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë pikët për cdo kriter vlerësimi të përcaktuar.

### **OSE**

#### **B) oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim**

**Në rastin e Marrëveshjes Kuadër, kur do të përdoret kriteri i vlerësimit të çmimit për njësi, për qëllime krahasimi, vlerësimi i ofertave do të kryhet në bazën e shumës së çmimeve për njësi (Kjo metodë e vlerësimit nuk do të përdoret nga autoritetet/entet kontraktore në rastet kur sasi të janë të vlerësueshme në bazë vjetore sipas përvojës së mëparshme dhe kur Marrëveshja Kuadër është përdorur për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve të vazhdueshme. Në rast të tillë çmimi më i ulët do të vlerësohet me vlerën totale më të ulët ofruar).**

Mbetemi në pritje të marrjes së ofertës suaj.

**[Drejtuesi i autoritetit /entit kontraktor]**

**Shtojca 3.**

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik i ftuar për të paraqitur ofertën)

**FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE**

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Shërbimeve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e kontratës;
3. Kriteret e përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafiku i ekzekutimit;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
---	--

---

<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

**Shtojca 4.***(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE****Data:** \_\_\_\_\_**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** \_\_\_\_\_**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë shërbimet në Formularin e Shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për Shërbime Shërbimet pa çmim do të konsiderohen si shërbime të pa ofruar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
<b>Shërbim i</b>	<b>Përshkrimi i shërbimit</b>	<b>Sasia</b>	<b>çmimi për njësi</b>	<b>Çmimi total për shërbim(3 x 4X)</b>	
1.	<b>Shërbim lavanderie për Spitalin Universitar të Traumës</b>	547,500 kg			
2.					
3.					
4					
	<b>Çmimi total (Shërbimet)</b>				_____

---

<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>	
<b>TVSH (%)</b>	
<b>Çmimi total me TVSH:</b>	
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë _____</b>	

**Shtojca 5.**

[ *Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik*]  
 [ *Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve* ]

**FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS**

Për: [ *Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor* ]

Në emër të: [ *Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar* ]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [ *lloji i procedurës* ]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [ *objekti* ]

Publikimi ( *nëse zbatohet* ): Buletini i Njoftimeve Publike [ *Data* ] [ *Numri* ] / Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

*Ne vërtetojmë se [ emri i ofertuesit të siguruar ] ka derdhur një depozitë pranë [ emri dhe adresa e bankës ] / është garantuar pranë [ emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit ] me një vlerë prej [ monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra ] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.*

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [ *emri i autoritetit/entit kontraktor* ] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentet e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentet e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [ *njoftimin e kontratës* ].

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

**Shtojca 6**

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

**Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

**VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Përfaqësuesi i Ofertuesit****Nënshkrimi****Vula**

**Shtojca 7.**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor ]

**FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE****Pjesa e parë: Informacion i përgjithshëm**

Operatori ekonomik kontraktues, do të ofrojë shërbimin e tij, nga procesi i lavanderisë deri tek kompletimi me inventarin e materialit të butë të shtratit të pacientit dhe mjekut roje (shtrimin/ndërrimin e materialeve në shtratit e pacientit/shtratit e mjekut roje).

Operatori Ekonomik duhet të sigurojë të gjithë materialin e butë të nevojshëm për një kompletim të rregullt, të të gjithë shtretërve që ka aktualisht SUT dhe **në qofte se do të ketë ndryshim të numrit të shtretërve gjatë zbatimit të Marrëveshjes Kuadër.**

**Të dhënat reale të gjendjes së shtretërve të pacienteve dhe të krevateve të vizitave sipas shërbimeve.**

**Tabela Nr.1**

Nr	Shërbimet ku janë vendosur shtretërit	Numri i shtretërve të pacienteve në pavione	Numri i krevateve të vizitave	Shuma
1	Shërbimi i Urgjencës	20	0	20
2	Shërbimi i Reanimacionit	12	0	12
3	Shërbimi i Neurokirurgjisë	22	0	22
4	Klinika e Kirurgjisë se Përgjithshme Nr.1	27	0	27
5	Klinika e Kirurgjisë se Përgjithshme Nr.2	25	0	25
6	Shërbimi i ORL-Okulistike-Kirurgji Maksilofaciale	15	0	15
7	Klinika e Ortopedisë Nr.1	28	0	28
8	Klinika e Ortopedisë Nr.2	26	0	26
9	Klinika e Ortopedisë Nr.3	28	0	28
10	Klinika e Sëmundjeve të Brendshme Nr.1	30	0	30



11	Klinika e Sëmundjeve të Brendshme Nr.2	28	0	28
12	Shërbimi i Imazherisë	5	4	9
13	Shërbimi i Fizioterapisë	12	0	12
14	Shërbimi i Kirurgjisë së Këmbës Diabetike dhe Angiokirurgjisë	15	0	15
15	Shërbimi i Konsultave të Specializuara Ambulatore	0	26	26
16	Blloku Operator i Shërbim Urgjencës	4	0	4
17	Blloku Operator	5	0	5
18	Shërbimi i Urgjencës Paraspitalore	11	0	11
19	Dhoma të përshtatshme për mjek roje	10	0	0
	<b>Totali</b>	<b>323</b>	<b>30</b>	<b>353</b>

Numri i shtretërve mbi të cilin do të llogaritet aktiviteti spitalor në SUT është 323.

Në numrin total të shtretërve përfshihen:

- Shtretër për pacientët të cilët marrin shërbim në Urgjencën e SUT-së,
- Shtretër për pacientët të cilët hospitalizohen,
- Shtretërit në të cilët pushojnë mjekët e shërbimit të rojes.

*Shënim: Numri i shtretërve është i ndryshueshëm në varësi të investimeve që janë parashikuar të kryhen në SUT në tre vitet në vazhdim. OE duhet të marrin si referencë këtë numër në mënyrë që të parashikojnë saktë kostot e shërbimit, të punonjësve që do të kryejnë shërbimin si dhe kostot e materialeve të buta (investimit që do të kryhet gjatë tre viteve).*

Materiali i butë duhet të ketë emërtimin/sigllën përkatëse të Autoritetit Kontraktues (Spitali Universitar i Traumës/SUT), datën e futjes së materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor. Inventari i materialit të butë, emërtimi, përmasat, dimensionet, cilësia dhe normat e përdorimit në kohë, do të përfshihen në specifikimet teknike përkatëse.

Operatori Ekonomik është i detyruar të disponojë të gjitha kapacitetet larëse, dezinfektuese, tharëse, hekurosëse dhe paketuese në lavanderinë e tij jashtë territorit të SUT.

Operatori Ekonomik duhet të sigurojë materialin e butë për zëvendësim nëse është i amortizuar gjatë gjithë periudhës kohore të vlefshmërisë së kontratës.

Operatori Ekonomik do të lajë, të dezinfektojë, të thajë, të paketojë, të transportojë dhe të shpërndajë në pavion bazën e materialit të butë si dhe të bëjë shërbimin e plotë të shtratit të pacientit/mjek roje.

Rregullat e shtrimit të shtratit do të bëhen sipas protokolleve të kujdesit infermieror, manualit të kujdesit spitalor, rregullave të higjenës me njoftimin e hapjes së kartelës së re të shtrimit nga K/infermieri i shërbimit si dhe sa herë nevojitet nga shërbimi (çdo informacion shtese do ti vihet në dispozicion OE të kontraktuar).

Larja dhe dezinfektimi, në repartin e lavanderisë do të bëhet në mënyre të përqëndruar, duke respektuar të gjitha procedurat dhe protokollat e higjenës, nga marrja në dorëzim e materialit të butë të papastër të ndarë sipas nëndarjeve dhe zonave të rrezikshmërisë (thasët me ngjyrë), tek dorëzimi i materialit të butë, të larë, të hekurosur dhe të paketuuar sipas këtyre protokolleve, deri në shtrimin e shtratit të pacientit sipas protokolleve infermiore. Pjesë e këtij procesi është edhe sigurimi i pastrimit të plotë kimik-mekanik, në temperaturat e duhura, dhe i procesit të hekurosjes.

Referuar standardeve dhe protokolleve për shërbimet spitalore, në vijim janë të detajuar lloji i materialit të butë që do të ketë për secilin pacient dhe që do të lahet si dhe materiali i butë për personelin mjekësor.

- *Materiali i butë i pacientit;*
  - Çarçafë shtrati (i poshtëm, i sipërm, zarf)
  - Jorgan (me vatinë)
  - Këllëf dysheku (Kundra Ujit)
  - Jastëk
  - Këllëf jastëku
  - Rrobdishan pacienti (Për të sëmurët që operohen)
- *Materiali i butë i personelit shëndetësor.*
  - Përparëse mjeku (të bardha)
  - Kostumet e Personelit Mjekësor (mjek/infermier/ndihmës)
  - Kostume te stafit (Koordinator Pacienti, barrelist etj)
  - Triko Mjeku dhe Infermieri
  - Pandofla personeli
  - Pandofla Personeli (salla operacioni)
  - Peshqirë personeli

Ndërrimi i shtratit të pacientit do të bëhet çdo tre dite ose dy herë në javë, si dhe në çdo rast që kërkohet nga kryeinfermieri i pavionit/shërbimit, si pasoje e shtrimit të pacienteve të rinj (me hapjen e kartelës klinike), ose në rastet kur ndryshimi i shtratit bëhet i domosdoshëm për të ruajtur dhe mbrojtur shëndetin e pacientit.

Në tabelën në vijim, jepet e detajuar shpeshësia e ndërrimit të çarçafëve, në disa prej shërbimeve të SUT-së, gjatë kësaj periudhe:

## **Tabela nr 2**

Nr.	Shërbimi	Shpeshësia e Ndërrimit të Çarçafëve
1	Shërbimi i Urgjencës & Blloku Operator i Urgjencës	Sa herë të jetë e nevojshme
2*	Shërbimi i Anestezi- Reanimacionit	1 x ditë
3*	Shërbimi i Neurokirurgjisë	1 x ditë të operuarit 1 x 3 ditë & para-operacionit dhe pas ditës së dytë të operimit
4*	Klinika e Kirurgjisë se Përgjithshme Nr.1 & Klinika e Kirurgjisë se Përgjithshme Nr.2	1 x ditë të operuarit 1 x 3 ditë & para-operacionit dhe pas ditës së dytë të operimit
5*	Klinika e Sëmundjeve të Brendshme Nr.1 & Klinika e Sëmundjeve të Brendshme Nr. 2	1 x 3 ditë
6*	Klinika e Ortopedisë Nr.1& Klinika e Ortopedisë Nr. 2 & Klinika e Ortopedisë Nr. 3	1 x ditë të operuarit 1 x 3 ditë & para-operacionit dhe pas ditës së dytë të operimit
7*	Shërbimi i ORL-Okulistike-Kirurgji Maksilofaciale	1 x ditë të operuarit 1 x 3 ditë & para-operacionit dhe pas ditës së dytë të operimit
8*	Shërbimi i Kirurgjisë se Këmbës Diabetike dhe Angiokirurgjisë	1 x ditë të operuarit 1 x 3 ditë & para-operacionit dhe pas ditës së dytë të operimit
9	Shërbimet e tjera të SUT (Fizioterapi, Imazheri, Konsultat etj.)	Sa herë të jetë e nevojshme
10	Dhomat e mjekëve roje	Çdo ditë

\*dhe sa herë të jetë e nevojshme me kërkesë të kryeinfermierit të pavionit

**Tabela 2/1** Tabele informuese për peshën dhe frekuencën e pritshme të larjeve të materialeve.

Nr.	Emertimi	Pesha (kg/cope)	Frekuenca e larjes
-----	----------	-----------------	--------------------

1	Çarçafë shtrati i poshtëm	0.73-0.82	<b>Sipas tabelës 2 sepse çarçafët kane peshën me te madhe te shërbimit</b>
2	Çarçafë shtrati i sipërm	0.73-0.82	
3	Çarçafë shtrati zarf	1.13-1.27	
4*	Jorgan me vatine	2.1	Në çdo shtrim të ri
5*	Këllëf dysheku (Kundra Ujit)	0.50	Ne çdo shtrim te ri
6*	Jastëk	0.88	Ne çdo shtrim te ri
7*	Këllëf jastëku	0.17-0.19	Ne çdo shtrim te ri
8	Rrobdishan pacienti (Për të sëmurët që operohen)	0.27	Pas çdo operacioni
9	Përparëse mjeku (të bardha)	0.36	2 x javë & Sa herë të jetë e nevojshme (Jo i gjithë personeli mjek preferon ta laje përparësen ne lavanderi)
10	Kostumet e Personelit Mjekësor (mjek/infermier/ndihmës)	0.55	2 x javë & Sa herë të jetë e nevojshme (Jo i gjithë personeli mjek dhe infermier preferon ta laje përparësen ne lavanderi)
11	Triko Mjeku dhe Infermieri	0.40	2 x javë & Sa herë të jetë e nevojshme (Jo I gjithë personeli infermier preferon ta laje trikon ne lavanderi)
12	Pandofla Personeli (salla operacioni)	0.76 (minimumi, pesha varion në varësi të numrit)	1 x javë & Sa herë të jetë e nevojshme (Vetëm për ekipin e Sallës se Operacionit te Urgjencës dhe Bllokut Operator Qendror)
13*	Peshqirë personeli	0.20	2 x javë

\*dhe sa herë të jetë e nevojshme me kërkesë të kryeinfermierit të pavionit

*Shënim: Për artikujt 1,2,3,7 pesha është përcaktuar duke patur parasysh specifikimet teknike: 160 – 180 gr/m<sup>2</sup>. Për artikujt e tjerë është kërkuar minimumi i peshës pasi këto mund te vajojnë sipas prodhuesve te ndryshëm dhe nuk mund te kufizohen.*

Me qellim informimin e OE pjesëmarrës, AK ka parashikuar se gjenerohen rreth 500 kg bazë materiale në ditë ose 182,500 kg në vit. AK nuk mund të përcaktojë saktë peshën për çdo artikull pasi nevojat në SUT janë te ndryshme dhe nuk mund të përcaktohen.

### Nevojat për inventar për material të butë

Numri i personelit i cili do të pajiset me uniforma në SUT

**Tabela nr 3**

Nr	Shërbimet mjekësore	Nr mjek	Nr infermier	Te tjera Profesione	Shpjegime
1	Drejtori i Përgjithshëm	1			
2	Zv/Drejtor i Përgjithshëm mjekësor	3			
3	Shërbimi i Urgjencës & Blloku Operator i Urgjencës	9	53	8	Barrelist
4	Shërbimi i Reanimacionit	17	43		
5	Shërbimi i Neurokirurgjisë	8	15		
6	Klinika e Kirurgjisë se Përgjithshme Nr.1	10	14		
7	Klinika e Kirurgjisë se Përgjithshme Nr.2	11	14		
8	Shërbimi i ORL-Okulistike-Kirurgji Maksilofaciale	17	9		
9	Klinika e Ortopedisë Nr.1	11	13	1	Infermier Gipsi
10	Klinika e Ortopedisë Nr. 2	11	13	1	Infermier Gipsi
11	Klinika e Ortopedisë Nr. 3	10	13	1	Infermier Gipsi
12	Spektori mjekësor i Gips-Protezimit			6	Teknik protezist
13	Klinika e Sëmundjeve të Brendshme Nr.1	20	12		
14	Klinika e Sëmundjeve të Brendshme Nr.2	15	11		
15	Shërbimi i Imazherisë	9		15	Teknik Imazherie
16	Shërbimi i Fizioterapisë	4		18	Fizioterapist
17	Shërbimi i Kirurgjisë se Këmbës Diabetike dhe Angiokirurgjisë	4	9		

18	Salla Shërbimi i Kirurgjisë se Këmbës Diabetike dhe Angiokirurgjisë		7		
19	Shërbimi i Konsultave të Specializuara Ambulatore	1	18		
20	Blloku Operator	1	29		
21	Shërbimi i Urgjencës Paraspitalore	10	15		
22	Mjekësia e Trupës Parandaluese	15	7		
	<b>Administrata</b>				
23	Kryeinfermier i Përgjithshëm		1		
24	Spektori mjekësor i parandalimit të infeksioneve spitalore	3	1		
25	Spektori i Koordinimit me Pacientin			7	Specialist koordinimi me pacientin
26	Shërbimi i Farmacisë	7			Farmacist
27	Spektori i Statistikes dhe informacionit Mjekësor		1		
28	Psikolog			3	Psikolog
	<b>Totali</b>	<b>197</b>	<b>298</b>	<b>60</b>	

• **Pjesa e dyte: Specifikime teknike dhe furnizim me materiale të buta**

Nevojat për material të butë për personelin mjekësor (uniforma dhe materiale të tjera) dhe personelin mbështetës janë llogaritur në bazë të numrit të personelit të SUT nga të dhënat e Burimeve Njerëzore duke u mbështetur në tabelën e organikës aktuale. Numri total i personelit që ka nevojë të pajiset me uniformë është 555.

Nevojat për material të butë për pacientët e SUT (Çarçafë dhe materiale të tjera) janë mbështetur në kapacitetin e shtretërve dhe të fluksit të pacientëve që marrin shërbim mjekësor.

Ak ka parashikuar sasinë e materialit të butë që do të furnizohet duke u mbështetur në të dhënat aktuale dhe eksperiencës së mëparshme për këtë shërbim. Në përlogaritje janë marrë parasysh ndryshimet që mund të ndodhin përgjatë periudhës 36 mujore të parashikuar. SUT mund të pësojë ndryshime në organikën e personelit dhe në planin e investimeve që janë parashikuar për tre vitet në vazhdim.

Operatori ekonomik duhet të plotësojë nevojat për inventar të butë për të gjithë personelin shëndetësor dhe profesione të tjera, si dhe duhet të bëjë kompletimin e shtratit të pacientit/mjekut roje.

Operatori ekonomik duhet të bëjë larjen dhe gjithashtu ripërtëritjen e materialit të butë sipas tabelës më poshtë.

Sasia e materialit të butë të pacientit që duhet ripërtërirë (blerë i ri)

**Tabela Nr 4**

N R	Emërtimi i artikujve	Njësi a	Sasia për vitin e parë	Sasia për vitin e dytë	Sasia për vitin e tretë	Total i për 3 vjet	Jetëgjatësia/ Afati i ndërrimit	Shënim
1	Dyshekë*	Copë	30	40	40	110	3 vjet	Për te gjithë shtretërit
2	Çarçaf Shtrati i Poshtëm	Copë	969	969	969	2907	1 vit	Për te gjithë shtretërit
3	Çarçaf Shtrati i Sipërm	Copë	646	646	646	1938	1 vit	Për çdo Shtrat. 15 Maj deri në 15 Shtator (periudha pranverë – verë & kur e kërkon pacienti për efekt të temperaturës)
4	Çarçaf zarf	Copë	646	646	646	1938	1 vit	Për çdo Shtrat. 16 Shtator -14 Maj (periudha vjeshtë – dimër dhe kur e kërkon

								pacienti për efekt të temperaturës)
5	Jorgan me Vatinë	Copë	390		390	780	2 vjet	Për çdo Shtrat
6	Këllëf dysheku (Kundra Ujit)	Copë	390		390	780	2 vjet	Për çdo Shtrat
7	Jastëk	Copë	390		390	780	2 vjet	Për çdo Shtrat
8	Këllëf Jastëku	Copë	969	969	969	2907	1 vit	Për çdo Shtrat
9	Rrobdishan salle (për të sëmurët që operohen)	Copë	150	150	150	450	1 vit	Për çdo të sëmurë që operohet

*\*Për dyshekët që do të furnizohen, grupi i punës ka parashikuar zëvendësimin e 1/3 të sasisë totale duke u mbështetur në investimet e kryera (dhe që parashikohet të kryhen nw tre vitet nw vazhdim), në shkallën e amortizimit tw dyshekwve nw inventar si dhe tw kërkesave të shërbimeve mjekësore në SUT.*



Sasia e materialit të butë të personelit shëndetësor që duhet ripërtërirë (blerë i ri)

**Tabela Nr 5**

NR	Emërtimi i artikujve	Njësia	Sasia për vitin e parë*	Sasia për vitin e dytë*	Sasia për vitin e tretë*	Totali për 3 vjet	Jetëgjatësia/ Afati i ndërrimit	Shënim
1	Përparëse ( Mjeku, Farmacist, Psikolog)	Copë	380	380	380	1140	1 vit	Për personelin (Mjek, Farmacist, Psikolog)
2	Kostumet e personelit mjekësor (Mjek, Infermier & ekipi i sallës)	Palë	1024	1024	1024	3072	1 vit	Për personelin (Mjek, Infermier & ekipi i sallës)
3	Triko Mjeku dhe Infermieri	Copë	523	523	523	1569	1 vit	Për personelin (infermier)
4	Pandofla Personeli	Palë	424	424	424	1272	1 vit	Për personelin (Mjek & infermier)
5	Pandofla Personeli për sallën e operacionit & sallën e urgjencës	Palë	120	120	120	360	1 vit	Për personelin (Mjek që futen në sallë & ekipi i sallës)
6	Peshqirë Personeli	Copë	512	512	512	1536	1 vit	Për të gjithë personelin(Mjek & infermier).
7	Barrelmbajtes	Copë	16	16	16	48	1 vit	Për personelin barrelmbajtes
8	Koordinator me Pacientin	Copë	14	14	14	42	1 vit	Për personelin Koordinator me Pacientin

**\*Sasia e parashikuar është dy uniforma për personelin (mjek, ekipi i sallës, infermier, farmacist, psikolog, barreimbajtes, koordinator me pacientin), pasi në momentin që Operatori Ekonomik tërheq kostumet për ti larë është e nevojshme të jetë një kostum rezervë.**

I gjithë materiali i butë duhet të ketë logon dhe emërtimin e MSHMS dhe SUT, datën e futjes në përdorim të stampuar në material jo të dëmshëm për pacientin. Ndërsa materiali i butë i personelit shëndetësor të ketë inicialet e emër, mbiemër dhe emërtimi (mjek, infermier, farmacist dhe profesione të tjera për të bërë dallimin).

## Specifikimet teknike të materialit të butë

Tabela nr 6

SPECIFIKIMET TEKNIKE TË MATERIALIT TË BUTË PËR PACIENTIN					
N R	Emërtimi	Njësi a	Specifikimet Teknike	Dimensionet	Lloji i materialit
1	<b>Dyshek</b>	Copë	<b>Dyshek Tek spitalor-</b> Dysheku të jetë ortopedik (me 3 ndarje), përbërja nga brenda me dy shtresa vatine të fortë, ku nga njëra anë të ketë porozitet për qarkullimin e ajrit, dhe i veshur nga jashtë me mbulesë të fortë të padepërtueshme, ignifugo (kundër zjarrit), antibakteriale dhe antialergjike. Mbulesa te jete me zinxhir anësor . Të ketë të shënuar datën e futjes në materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor. Ngjyra sipas kërkesës se autoritetit kontraktor.	190x90x10 cm- 190x90x25 cm  (sipas kërkesave te pavionit)	Veshja e dyshekut me mbulesë (mushama) të padepërtueshme nga uji apo lëngjet biologjike.
2	<b>Çarçaf shtrati i poshtëm</b>	Copë	160 – 180 gr/m2, Me qepje nga të katërta anët. Ngjyrë e bardhë. Logo MSHMS dhe SUT. Të ketë të stampuar datën e hyrjes së materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor.	270 x 170 cm	Materiali 75 % Pambuk X 25 % Polyestër . Lahet në temperaturë 60°. Të jetë i hekurosuar dhe pa rrudha.
3	<b>Çarçaf shtrati i Sipërm</b>	Copë	160 – 180 gr/m2, Me qepje nga të katërta anët. Ngjyrë e bardhë. Logo MSHMS dhe SUT. Të ketë të stampuar datën e hyrjes së materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor.	270 x 170 cm	Materiali 75 % Pambuk X 25 % Polyestër . Lahet në temperature 60°. Të jetë i hekurosuar dhe pa rrudha.
4	<b>Çarçaf Zarf</b>	Copë	160 – 180 gr/m2 . Dy fletësh, me qepje nga të tre anët, i çarë në fund për të mundësuar futjen e jorganit ne forme zarfi. Ngjyrë e bardhë. Logo MSHMS dhe SUT. Të ketë të stampuar datën e hyrjes së materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor.	220 x 160 cm	Materiali 75 % Pambuk X 25 % Polyestër . Lahet në temperaturë 60°. Të jetë i hekurosuar dhe pa rrudha.

5	<b>Jorgan me vatinë</b>	Copë	Me mbushje me vatinë , me tegela ndarëse në formë kuadrati, veshja e jashtme material pambuku, ngjyrë e bardhë. Logo MSHMS dhe SUT	200 X 140 cm	Mbushje me fibra sintetike
6	<b>Këllëf dysheku (Kundra Ujit)</b>	Copë	Material komplet e gomuar (i papërshkueshëm nga uji) me përmasa 190 x 90 cm qepje me llastik per te futur dyshekun.	190 x 90. Lartesia 10 -15 cm (nga te kater anet)	Materiali i gomuar , I papërshkueshëm nga uji, Lahet në temperaturë te lartë.
7	<b>Jastëk</b>	Copë	Mbushje uniforme me fibra sintetike, ngjyrë e bardhë, me mbulesë dyshe.	50 x 80 cm	Mbushje me fibra sintetike
8	<b>Këllëf Jastëku</b>	Copë	Mbulesë dyshe, ku nga njëra anë ka një të çarë si xhep, për të lejuar futjen e jastëkut. Ngjyrë e bardhë. 160 – 180 gr/m2. Logo MSHMS dhe SUT. Të ketë të stampuar datën e hyrjes së materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor.	60 x 90 cm	Materiali 75 % Pambuk X 25 % Polyestër . Lahet në temperaturë 60°. Të jetë i hekurosur dhe pa rrudha.
9	<b>Robdishan salle (Për të sëmurët që operohen</b>	Copë	Robdishan i hapur në të dy pjesët anësore , me lidhëse ose perçina. Me mëngë të shkurtra. Logo MSHMS dhe SUT. Të ketë të stampuar datën e hyrjes së materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor.	Gjatesia 150 cm	Materiali 100 % pambuk

Tabela nr 7

SPECIFIKIMET TEKNIKE TË MATERIALIT TË BUTË TË PERSONELIT MJEKËSOR					
N r.	Emërtimi	Njësia	Specifikimet Teknike	Dimensio net	Lloji I materialit
1	Përparëse Mjeku (Unisex)  Ngjyra e Bardhe	Copë	Me mënge te gjata, me kopsa me percina, me dy xhepa anash, me ngjyre te bardhe, me logo MSHMS dhe SUT. Pjesa e mbrapme me te carë.	S,M,L,X L,XXL	Përzierje 65% pambuk 35% Poliester, Larje ne 60°.
2	Kostume Infermieri  (Bluzë me Pantallona  Unisex)  <i>(Gjate dimrit vishet bluze e bardhe me mënge te gjata poshtë kostumit)</i>	Copë	Bluza me jakë V të trashë me mënge te shkurtra (trecerekshe) dhe dy xhepa anësore poshtë me ngjyrën sipas llojit te shërbimit dhe me logo MSMSH dhe SUT ne te djathte:  <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Infermier Pavioni:</b> Ngjyra bojeqielli e hapur</li> <li>• <b>Mjek dhe Infermier Urgjence, Mjek dhe infermier Bloku Operator:</b> Ngjyra Blu e erret</li> <li>• <b>Mjek dhe infermier Reanimacioni:</b> Ngjyra Jeshile e erret</li> <li>• <b>Teknik imazherie:</b> Bluza dhe pantallonat ngjyre gri</li> <li>• <b>Fizioterapia:</b> Bluza me tre komça (T-shirt Polo) me menge te shkurtra, pantallonat (tuta) ngjyre blu e erret ose e zeze <i>(Gjate dimrit vishet bluze tute me mënge te gjata)</i></li> </ul>	(S,M,L,X L,XXL)	Përzierje 65% pambuk 35% Poliester
3	Triko Mjeku dhe Infermieri	Copë	Material 100% poliestër 260gr/m <sup>2</sup> . me mengë të gjata. me dy xhepa . Me zinxhir.	(S,M,L,X L,XXL)	Materiali 100% poliestër
4	Pandofla Personeli	Copë	Pandofla për përdorim spitalor, material plastik, me gomë poroze me ngjyra të ndryshme, e mbyllur nga përpara dhe me vrima për ajrosje, e pajisur me një shtresë ortopedike për të lehtësuar qëndrimin për kohë të gjatë në këmbë. Materiali të jetë antirrëshkitës, rezistentë ndaj gërryerjes dhe vajit, si dhe i padepërtueshëm nga uji.	Numrat e pandoflav e sipas kërkesës së Autoritetit Kontrakt or.	Materiali të jetë plastik, antirrëshkitës, rezistentë ndaj gërryerjes dhe vajit, si dhe i padepërtueshëm nga uji

			Ngjyra sipas kërkesës së autoritetit kontraktor.		
5	Pandofla Personeli (Për sallat e operacionit)	Copë	Pandofla për përdorim në sallat e operacionit, material plastik, me ngjyra të ndryshme, e mbyllur nga përpara dhe me vrima për ajrosje, e pajisur me një shtresë ortopedike për të lehtësuar qëndrimin për kohë të gjatë në këmbë. Materiali të jetë antirrëshkitës, rezistentë ndaj gërryerjes dhe vajit, si dhe i padepërtueshëm nga uji. Ngjyra sipas kërkesës së AK.	Numrat e pandoflav e sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor.	Materiali të jetë plastike, antirrëshkitës, rezistentë ndaj gërryerjes dhe vajit, si dhe i padepërtueshëm nga uji
6	Peshqirë personeli	Copë	Material pambuku, ngjyrë e bardhë , Logo MSHMS dhe SUT	90 x 60 cm	100% pambuk, lahet në temperaturë 60°.
7	Barrelambajtes (Bluzë me Pantallona Unisex) <i>(Gjate dimrit vishet bluze e bardhe me mënge te gjata poshtë kostumit)</i>	Copë	Me logo MSMSH dhe SUT ne te djathte ne ngjyrën e bardhe	(S,M,L,X L,XXL)	Përzierje 65% pambuk 35% Poliester
8	Koordinator me Pacientin	Copë	Pantallona te zeza, T-Shirt POLO me ngjyre gri me tre komça me logon e MSHMS dhe SUT ne te majte. (gjate dimrit vishet xhakete e zeze ose triko e zeze)	(S,M,L,X L,XXL)	

*Shënim: Mbasi të jetë lidhur kontrata me OE, gjatë procesit të marrjes në dorëzim të bazës materiale nga SUT, do të ngrihet një komision i cili duhet të bëjë peshimet e të gjithë zërave të mësipërme për të saktësuar peshën dhe marrë në dorëzim sasinë e materialeve në bazë të specifikimeve teknike. Ky proces duhet të bëhet në prezencën e OE dhe do të firmoset nga të dyja palët. Peshat e bazës materiale do të përdoren në fund të çdo muaji për përllogaritjen e kilogramëve për faturimin mujor.*

- *Materialet të jenë të shoqëruara me certifikatë analize dhe me logon MSHMS dhe SUT-së.*
- *Materialet ti përgjigjen standardeve STASH në fuqi dhe standardeve europiane CE.*
- *Kontraktuesi duhet të plotësojë kushtin teknik paraqitjen e mostrave për çdo artikull.*

### **Specifikimet teknike të Menaxhimit të Procesit të Lavanderisë**

**Larja e inventarit të materialit të butë do të bëhet sipas kërkesave të Ak duke marrë si referencë frekuencat e përcaktuara në tabelën nr. 2 (frekuencat janë parashikime por mund të ndryshojnë sipas nevojave aktuale të shërbimeve mjekësore).**

Tërheqja dhe dorëzimi i inventarit të materialit të butë në pavione, do të bëhet me pasqyrën përmbledhëse të hartuar nga përfaqësuesit e Komisionit të Posaçëm për Shërbimin e Lavanderisë në SUT. Pasqyra përmbledhëse është e detyruar të zbatohet nga të dyja palët.

Përdorimi i inventarit të materialit të butë brenda pavionit, bëhet dhe mbetet nën përgjegjësinë e personelit të sipërmarrësit të kontrolluar nga AK, sipas procedurave të mëposhtme:

#### **Etapat e këtij procesi çdo ditë:**

- Çdo ditë, Kryeinfermieri i pavionit ose personi i autorizuar prej tij, në bazë të shtrimeve në pavion, shtrimeve të reja dhe daljeve, grafikut ditor të ndërrimit të materialit të butë do të hartojë fletë - daljen ditore të cilën do ta dorëzojë pranë Komisionit të Posaçëm për Shërbimin e Lavanderisë në SUT brenda orës 14:30.
- Komisioni për Shërbimin e Lavanderisë në SUT, harton pasqyrën përmbledhëse në bazë të fletë daljeve ditore dhe ia dorëzon O.E. për zbatim.
- Komisioni për Shërbimin e Lavanderisë në SUT, në bazë të pasqyrës përmbledhëse (fletë dalje) bën pritjen e mallit cdo dite dhe harton proces - verbalin ditor. Për të kontrolluar procesin e dorëzimit apo hyrjes së mallit dhe për të përlllogaritur saktë faturat mujore përkatëse: Material i butë do të dalë me copë (sipas llojeve përkatëse) dhe do të bëhet hyrje në Kg.
- OE duhet të ketë gjendje rezervë në depon qendrore në SUT, material të butë për të shtruar të gjithë shtretërit në raste urgjente, në raste të gjëndjes së jashtëzakonshme, epidemive apo pandemive.
- Shpërndarja e materialit të butë në të gjithë shërbimet e SUT-së, bëhet sipas pasqyrës përmbledhëse të hartuar nga përfaqësuesit e Komisioni te Posaçëm për Shërbimin e Lavanderisë në SUT nga ora 7:00 deri në orën 15:00 të ditës, me fletë hyrje.
- Punonjësit e shpërndarjes së materialit të butë duhet të jenë të pajisur me uniformë si dhe me mjete e shenja dalluese përkatëse të kontraktuesit, me bashkëpunim të SUT.
- Kontraktuesi do të zëvendësojë çdo punonjës nëse A.K konstaton se personi kryen veprime të jashtëligjshme gjatë ushtrimit të profesionit të tij.
- Punonjësit duhet të sillen me edukatë dhe kortezi, si gjatë zhvillimit të shërbimit dhe gjatë qarkullimit brenda ambienteve të SUT.
- Personeli duhet të jetë i pajisur me kontratë të rregullt pune, të kryhet pagesa e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, të jepet leja e zakonshme sipas kodit të punës, si dhe të jetë i pajisur me librezë shëndetësore nga Inspektoriati Sanitar Shëndetësor.
- Punonjëset e materialeve të buta, mund të ndërrojnë deri në 35 shtretër pacienti në ditë (maksimumi).
- Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të ushtrojë kontroll në ambientet e lavanderisë, depos qendrore në SUT dhe depove të materialeve të buta nëpër pavione, në prani të përfaqësuesit të Operatorit Ekonomik.
- Operatori Ekonomik i kontraktuar duhet të ofrojë shërbimin e grumbullimit të të gjithë materialit të butë të papastër në bazë të rregullores së parandalimit të infeksioneve nozokomiale, transportimin e tij në lavanderi, seleksionimin, larjen, tharjen, hekurosjen, paketimin, transportimin sërish mbrapsht në Shërbime (ku materiali i larë nuk duhet të ketë kontakt me

materialin e palarë për të shmangur infeksionet), deri në shtrimin e shtratit të pacientit në të gjitha shërbimet e SUT-së.

- Operatori ekonomik siguron inventarin e materialit të butë, për një kompletim të rregullt sipas normave të shtratit që ka SUT, me emërtim dhe siglën përkatëse të SUT, për secilin artikull të parashikuar në specifikimet teknike.
- **Procesi i marrjes në dorëzimi i inventarit në pavion**, do të bëhet me dokument të rregullt (flete hyrje) të nënshkruar nga kryeinfermieri/ja i/e pavionit ose personi i autorizuar prej tij, pas numërimit, kontrollit për hekurosjen, cilësinë e materialit të butë të larë në lavanderi (në bazë të flete daljes të sjellë një ditë më parë te Komisioni për Shërbimin e Lavanderisë në SUT). Ky dokument (Flete hyrje) duhet të jetë në tre kopje, të miratuar nga "Autoriteti Kontraktor" dhe "Operatori Ekonomik".
- Shtrimi i shtratit të pacientit do të ofrohet gjatë gjithë javës, nga e hëna në të dielë.
- Shtrimi i shtratit të pacientit në shërbimin e Pranim Urgjencës dhe Reanimacionit do të jetë shërbim 24 orësh, ndërsa për pjesën tjetër të SUT si për shtrimet e reja ashtu edhe shtrimet urgjencë, nga ora 15:00 deri në orën 07:00 të mëngjesit të ditës së nesërme do të jetë nën përgjegjësinë e Operatori Ekonomik, duke lënë një punonjës të lëvizshëm i cili do të kontaktohet me telefon nga personeli shëndetësor sipas turneve përkatëse.
- Tërheqja e materialeve të ndotura (të përdorura) nga pavioni, do të bëhet nga sipërmarrësi deri në orën 15:00.
- Kryeinfermieri i pavionit do të evidentojë dhe konfirmojë në mënyrë të vazhdueshme lidhur me shërbimet që kryhen, cilësinë dhe sasinë e kërkuar, si dhe për çdo parregullsi do informojë Komisionin e Posaçëm për Shërbimin e Lavanderisë në SUT.
- Për raste të gjendjes së jashtëzakonshme, epidemive apo pandemive, lavanderia do të funksionojë sipas kushteve që vendos Drejtoria e SUT-së.
- **Riparimi i inventarit të dëmtuar, bëhet nga sipërmarrësi duke ruajtur përmasat, dimensionet dhe përbërjen fillestare.**
- Operatori Ekonomik do të largojë vetë mbetjet urbane që gjenerohen gjatë ofrimit të shërbimit.
- **Operatori ekonomik do ti sigurohet një ambient si depo qëndrore dhe ambiente të përcaktuara në cdo pavion të cilat do ti jepen me qera sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.**
- **Këto mjedise nuk mund të tjetërsohen. Kur janë të nevojshme të bëhen përshtatje, për shkaqe teknologjike, merret miratimi me shkrim nga SUT-ja.**
- **Të gjitha kostot për ofrimin e shërbimit të lavanderisë dhe hotelerisë në SUT, janë përgjegjësi dhe do të sigurohen nga vetë Operatori Ekonomik.**
- **Inventari i materialit të butë të shtratit të pacienteve dhe i veshjeve të personelit mjekësor janë në ngarkim të Operatori Ekonomik dhe administrohen nga ai deri në përfundim të kontratës së shërbimit. Me përfundimin e kontratës së shërbimit, inventari i butë në përdorim të pacientit do të tërhiqet nga AK dhe ai në përdorim të personelit mjekësor do të mbahet nga personeli përkatës sipas furnizimeve periodike.**
- **Marrëdhëniet financiare midis palëve, do të përcaktohen në momentin e lidhjes së kontratës.**
- *I gjithë procesi i larjes (ku përfshihen lloji i detergjenteve të përdorur, mënyra e larjes sipas ndarjes së materialeve etj.) do të kontrollohet në vendndodhjen e lavanderisë (vendi ku do të kryhet aktiviteti) të paktën një herë në muaj nga grupi i punës i ngritur për ndjekjen dhe*



*zbatimin e kontratës në SUT. Komisioni i Posaçëm do të mbajë një proces-verbal në rast se konstaton mangësi në cilësinë e larjes apo në vonesat e furnizimit me materialet e pastërtia dhe ky proces-verbal do të jetë pjesë e aktrakordimeve mujore përkatëse ku do të mbahen dhe penalitetet sipas parashikimeve të kontratës.*

**Shënim:** Kjo peshë e bazës materiale është parashikim por mund të ndryshojë sipas nevojave dhe fluksit të pacientëve në SUT përgjatë periudhës 36 mujore.

**Shtojca 8**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

**FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT**

**Shërbimi që kërkohet: kryerja e shërbimit të lavanderisë në Spitalin Universitar të Traumës**

**Afatet e ekzekutimit: 36 muaj**

<b>Shërbimi</b>	<b>Përshkrimi</b>	<b>Shuma</b>	<b>Vendi i ekzekutimit</b>	<b>Afati i ekzekutimit</b>
Shërbim lavanderie për Spitalin Universitar të traumës	Sipas specifikimeve teknike dhe termave të referencës	547,500 kg	Spitali Universitar i Traumës	Sipas nevojave të AK, brenda periudhës së vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër

## Shtojca 9

### FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: **“Kryerja e Shërbimit të Lavanterisë për Spitalin Universitar të Traumës”**.

**Rregullat për qarkullimin e materialit të butë në pavionet e SUT-së, për parandalimin, eliminimin e infeksioneve spitalore, të miratuara nga grupi I monitorimit të MSHMS për procesin e akreditimit të spitalit.**

#### 1. Procedura e grumbullimit të materialeve të ndotura:

- Personeli i OE bën ndarjen e materialeve të ndotura pas çdo ndërrimi të shtratit të pacientit.
- Materialet e kontaminuara lëvizen nga shtrati i pacientit të karroca e lëvizshme në thesin përkatës.
- Mbledhja e materialeve të kontaminuara bëhet në thasët e vendosur në karrocën e shpërndarjes së teshave pas çdo ndërrimi të shtratit. (Karroca është e lëvizshme. Në pjesën e përparme ka një dollap ku vendosen materialet e pastra. Në pjesën e pasme ose anësore ka dy kosha me thasë të vegjël të mbyllur ku vendosen materialet e kontaminuara).
- Kur thesi është i mbushur në 2/3 e tij, ai transportohet në karrocën e madhe, në vendin e posaçëm (i përcaktuar në pavion) dhe bëhet gati për të dërguar në lavanderi në orarin e përcaktuar.  
(Materialet që nga ndarja verifikohen dhe nëse kanë rrezikshmëri, personeli i OE i dërgon në incenerator për tu djegur nga personeli përgjegjës i SUT).
- Karroca e madhe është e vendosur në pavion, në një vend të përcaktuar nga shërbimi e mbuluar dhe me rafte të posaçme në brendësi për vendosjen e thasëve të specifikuar dhe të mbyllur me materialet e kontaminuara.
- Thasët identifikues janë me ngjyrë (sipas kërkesës së AK).
- Karroca e shpërndarjes së materialeve shërben për mbajtjen e materialeve të pastra dhe ka kosha ku vendosen thasët për materialet e kontaminuara.
- Kjo karrocë nuk futet në dhomat e pacientëve por qëndron te dera e dhomës në korridor.
- Në momentin e ndërrimit të pacientit duhet të largohet çdo objekt duke bërë kujdes (Çfarë mund të ketë mbi shtrat).
- Materialet e kontaminuara (materialet me sëmundje ngjitëse) vendosen në qese të posaçme dhe dërgohen për tu djegur në incenerator.

**Përkujdesje:** Lahen duart në çdo ndërrim shtrati nëpërmjet kësaj procedure – Kryhet një larje e thjeshtë dhe më pas një fërkim hidroalkoolik të duarve, pasi të keni manipuluar me materialet e kontaminuara.

#### 2. Procedura e ruajtjes dhe shpërndarjes së materialeve të pastra:

---

Operatori Ekonomik që ofron shërbimin e lavanderisë duhet të disponojë të gjitha kapacitetet larëse, tharëse, dezinfektuese, hekurosese dhe paketuese.

- Të gjitha materialet me të cilat behët ndërimi i shtratit të pacientit janë të lara, hekurosurat dhe të ruhen të paketuara në qese.
- Materialet e pastra mbahen në dollap në dhomën e përcaktuar në çdo pavion.
- Materialet e pastra vendosen në karrocën e shpërndarjes në pavione dhe ndahen sipas një grafiku ditor të përcaktuar nga K/infermieri i pavionit.
- K/infermieri i pavionit çdo ditë shikon cilësinë e larjes, hekurosjes dhe paketimit të materialeve.
- Të gjitha materialet e shtratit të pacientit janë të ndara dhe të paketuara sipas zërave.
- Materialet e pastra nuk bashkohen me materialet e ndotura.
- Çdo shërbim ka dhomën në dispozicion për depozitimin dhe ruajtjen e materialeve të pastra të cilat gjithmonë duhet të jenë të palosura dhe të paketuara.

**Vendi i kryerjes së shërbimeve:** Në ambjentet e Spitalit Universitar të Traumës

## Shtojca 10

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

